



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE TEKNIKE, KORÇË**

Nr. 131 prot.

Korçë, më 19.10.2023

Lënda : Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Ofruesi publik i AFP-së Shkolla Profesionale Teknike , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- 1.Kryetare Degës së Financës dhe Administrimit/ Nëpunës zbatues

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- të ketë diplomë studimi të ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuara me të .
- të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacion e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;

- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

30.10.2023.

Drejtor

Anxhela TAHO

